



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr.27/2017**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Hasan Shala dhe Nenad Lazić anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e Selvije Kurtit nga Mitrovica, kandidate për asamblenë komunale në Mitrovicë nga iniciativa qytetare “Te pavarurit e Mitrovicës”, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.22/2017, të datës 16.01.2017, lidhur me mos emërimin e saj si anëtare të Kuvendit Komunal të Mitrovicës, në seancën e panelit të mbajtur me 20.03.2017, mori këtë:

**V E N D I M**

**REFUZOHET** si i papabazuar apeli i Selvije Kurti, kandidate për asamblenë komunale në Mitrovicë nga iniciativa qytetare Te pavarurit e Mitrovicës, i paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me Nr.Prot.22/2017 të datës 16.01.2017.

**A r s y e t i m**

Me datën 15.03.2017, Selvije Kurti kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal të Mitrovicës nga Iniciativa Qytetare “Të pavarurit e Mitrovicës” ka paraqitur apel Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), kundër vendimit të KQZ-së, me Nr.Prot.22/2017, të datës 16.01.2017, ku pretendon se KQZ, pas dorëheqjes së bartësit të listës të iniciativës qytetare nga funksioni i anëtarit të Kuvendit Komunal të Komunës së Mitrovicës, me vendimin e saj ka certifikuar si asambleist, kandidatin me më pak vota se sa parashtruesja e apelit, me arsyetimin se zëvendësimet në Kuvendin Komunal, bëhen me personat e gjinisë së njëjtë. Parashtruesja e apelit pretendon se në rast konkret duhet të zbatohet legjislacioni për kuotën gjinore pasi që ka për qëllim të hap rrugën për pjesëmarrjen e grave në politike, si dhe të indihmojë gratë në tejkalimin e pengesave për pjesëmarrje në politik, andaj ka propozuar që ankesa e saj të miratohet si e bazuar.

PZAP-i, në kuptim të nenit 11 paragrafi 7 të rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, njoftoi KQZ-në, lidhur me apelin e parashtruar në PZAP, dhe kërkoi që deri me datë 17.03.2017, të ofroj përgjigje lidhur me këtë. KQZ në përgjigjen e saj Nr.Prot.236/A-2017, thekson se me vendimin Nr.Prot.22/2017 të datës 16.01.2017 KQZ, ka emëruar z.Fisnik Pllanën si anëtar të Kuvendit Komunal të Mitrovicës, nga radhët e subjektit politik të “Pavarurit e Mitrovicës”, duke zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal

z. Ahmet Demaj. Sipas parashtrimeve të KQZ pretendimet e apelueses nuk kanë bazë ligjore për faktin se vendimi kontestues është marrë në mbështetje të dispozitës së nenit 10.3 pika a) të Ligjit për Zgjedhjet Lokale.

PZAP-i, pas administrimit të pretendimeve ankimore, vendimit kontestues të datës 16.01.2017 me numër protokolli 22/2017 të KQZ-së dhe përgjigjes në apel të KQZ-së gjeti se:

Apeli është i pabazuar

PZAP, duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit kontestues Nr.Prot.22/2017 të datës 16.01.2017, ka gjetur se njëjti është në harmoni me dispozitën e nenit 10.3 pika a) të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, ku parashihet që, *KQZ plotëson vendin e lirë sipas kriterëve të përcaktuara në vijim: a) nga kandidati i radhës i kualifikuar të njëjtës gjini që gjendet në listën e rirenditur të kandidatëve të njëjtit subjekt politik.*

Nga shkresat e lëndës, rezulton se Vendimi i KQZ-së Nr.Prot.22/2017 të datës 16.01.2017, është marrë në pajtim me nenin 10.3 pika a) të Ligjit sipërcituar, për faktin se kandidati i emëruar Fisnik Pllana është antar i subjektit të njëjtit politik "Të Pavarurit e Mitrovicës" dhe i të njëjtës gjini, pasi që antar i Komunës së Mitrovicës Kuvendit, më parë ka qenë kandidati Ahmet Demaj i të njëjtit subjekt.

Bazuar në këto që u theksuan më lartë PZAP, konstaton se pretendimet e parashtruara në apel janë të pabazuara, dhe si të tilla i refuzoj për faktin se vendimi KQZ-së, me Nr.22/2017 i datës 16.01.2017, është i drejtë dhe i bazuar në ligj, pasi që zëvendësimet për anëtarë të kuvendit komunal bëhen duke marrë parasysh kandidatin e radhës të njëjtës gjini dhe të njëjtit subjekt politik, ashtu si është vepruar edhe në rastin konkret.

Për arsyet e cekura si më lartë e në pajtim me nenin 115.1 lidhur më nenin 118.1 të LZP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Anr. 27/2017 më datën 20.03.2017



**Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur,  
mund të paraqet ankesë brenda afatit  
prej njëzet e katër (24)orëve nga momenti  
i marrjes-pranimimit të këtij vendimi  
në Gjykatën Supreme të Kosovës.